

LIGJ
Nr.7677, datë 3.3.1993

PËR TATIMIN MBI FITIMIN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në këtë ligj, me përjashtim të rastit kur në të përcaktohet ndryshe:

- Fitimi përfaqëson tepricën e të ardhurave mbi shpenzimet e kryera për arritjen e këtyre të ardhurave.

"Territor" nënkupton territorin që Shqipëria ka në sovranitet, përfshirë ujrat territoriale, si dhe zonën detare në shelfin kontinental, mbi të cilat Shqipëria në përputhje me normat ndërkombëtare ushtron të drejtat sovrane e ligjore.

Neni 2

Fitimi vjetor i realizuar nga veprimtaria ekonomike e personave juridikë vendas dhe të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet tatimit.

Neni 3

Detyrimi për pagimin e tatimit mbi fitimin, shtrihet nga dita e fillimit deri në ditën e mbarimit të veprimtarisë ekonomike.

Neni 4

Fitimi i tatueshëm është fitimi vjetor që llogaritet mbi bazën e fitimit që pasqyrohet në bilancin kontabël. Llogaritja e fitimit të tatueshëm, bëhet sipas ligjit nr.7661, datë 19.3.1993 "Për kontabilitetin" dhe udhëzimeve që nxjerr Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për bashkitë ekonomike fitimi i tatueshëm llogaritet mbi bazën e fitimit vjetor të çdo ndërmarrje që bën pjesë në bashkësi.

Këshilli i Ministrave ka autoritetin që për raste të veçanta të bëjë përjashtime nga pagimi i tatimit mbi fitimin për ndërmarrjet që bëjnë pjesë në bashkësitë ekonomike.

Neni 5

Fitimi nga veprimtaria ekonomike e personave juridikë vendas dhe të huaj, shtetërore apo private tatohet në masën 30 për qind.

Fitimi i personave juridikë vendas dhe të huaj, që ushtrojnë veprimtari në degën e turizmit veç atyre që përjashtohen nga ligji nr.7665 datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", tatohet në masën 40 për qind.

Neni 6

Fitimi i personave juridikë privatë vendas dhe të huaj që ushtrojnë veprimtarinë në sferën prodhuese, për 10 vjet të njëpasnjëshëm e lart, përjashtohen nga fitimi për katër vite pas fillimit të aktivitetit prodhues.

Nuk e përfitojnë këtë lehtësi tatimore personat juridikë të përmendur në nenin 7.

Kur këta persona juridikë, të cilët përfitojnë lehtësi tatimore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre e prishin kontratën para afatit 10 vjeçar, datyohen të paguajnë të gjitha lehtësitë tatimore që kanë përfituar sipas këtij neni deri në momentin e prishjes së kontratës.

Neni 7

Fitimi i personave juridikë me kapital të zotëruar 100 për qind nga të huajt apo me kapital të zotëruar pjesërisht nga vendasit dhe pjesërisht nga të huaj, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, në shfrytëzimin e naftës dhe gazit në det, tatohet në masën 50 për qind.

Neni 8

Humbjet që rezultojnë nga veprimtaria ekonomike e personave juridikë gjatë vitit kalendarik, zbriten nga fitimi i realizuar gjatë 3 viteve pasardhëse.

E drejta e zbritjes së humbjeve nga fitimi i viteve pasardhëse humbet në rastin e shkrirjes ose riorganizimit të subjektit.

Neni 9

Personat juridikë me kapital të huaj për pjesën e fitimit, që transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, paguajnë një tatim prej 10% të shumës së fitimit që transferohet.

Nga ky tatim përjashtohen personat juridikë me kapital të huaj që kanë lidhur kontratë për kërkimin e naftës në det.

Neni 10

Për personat juridikë privatë të cilët ushtrojnë veprimtari në peshkim, fitimi i tatueshëm llogaritet sipas udhëzimit të veçantë të nxjerrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Neni 11

Personave juridikë privatë vendas, me kapital të zotëruar pjesërisht apo tërësisht nga të huajt, që pjesën e tyre të fitimit e riinvestojnë në sferën prodhuese në territorin e Republikës së Shqipërisë, u bëhet një zbritje 60 për qind në tatimin e paguar për shumën e riinvestuar. Këtë të drejtë nuk e përfitojnë ata që fitimin e mbajnë në formë depozitash.

Neni 12

Personat juridikë vendas dhe të huaj për fitimin e realizuar, janë të detyruar të paraqesin në organet tatimore këto deklarata:

- Deklaratën për parashikimin e fitimit që do të realizohet gjatë vitit.
- Deklaratën tremujore për parashikimin e fitimit.
- Deklaratën vjetore të fitimit të realizuar së bashku me bilancin kontabël, sipas statutit të personit juridik.

Deklarata vjetore dhe bilanci kontabël plotësohen sipas modeleve që përcakton Ministria e Financës dhe Ekonomisë dhe paraqiten në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Neni 13

Tatimi mbi fitimin derdhet çdo tremujor në buxhetin e shtetit në formë paradhënie, deri në datën 10 pas mbylljes së tremujorit. Subjektet juridike që krijohen gjatë vitit, tatimin e derdhin në varësi nga madhësia e fitimit që pritet të realizohet.

Rrillogaritja vjetore për efekt të derdhjes së tatimit, bëhet jo më vonë se 15 ditë nga data e paraqitjes së bilancit kontabël.

Neni 14

Quhen shkelje të këtij ligji:

- Fshehja e fitimit dhe e të ardhurave.
- Falsifikimi i të dhënave dhe i dokumenteve që përcaktojnë fitimin dhe të ardhurat.
- Mosparaqitja në afatin e caktuar e deklaratës së fitimit të parashikuar dhe të realizuar dhe llogarisë vjetore për të ardhurat dhe shpenzimet.
- Mosrespektimi i afateve të derdhjes së tatimit.
- Raportimi i gabuar i llogarive kontabël mbi të ardhurat dhe shpenzimet dhe të rezultatit ekonomik.

Neni 15

Shkeljet e mësipërme, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, dënohen dhe me këto masa administrative:

- Fshehja e fitimit dhe e të ardhurave si dhe falsifikimi i të dhënave dhe i dokumenteve që përcaktojnë fitimin dhe të ardhurat, me gjobë në masën 5 fish të shumës së tatimit, që rezulton nga llogaritja e fitimit të fshehur dhe me marrjen 100 për qind të tatimit të fshehur.
 - Mosparaqitja në afatin e caktuar të deklaratës së fitimit të parashikuar dhe të realizuar dhe e llogarisë vjetore për të ardhurat dhe shpenzimet, me gjobë nga 6000-8000 lekë.
 - Mosrespektimi i afateve të derdhjes së tatimit, me gjobë në masën 6000 - 8000 lekë.
- Raportimi i gabuar i llogarive kontabël mbi të ardhurat, shpenzimet dhe mbi rezultatit ekonomik, me gjobë nga 6000-8000 lekë.

Neni 16

Personat juridikë të cilët përfitonin lehtësi tatimore sipas nenit 6 të ligjit nr. 7544, datë 6.1.1992, ndryshuar me ligjin nr. 7587, datë 14.7.1992 "Për tatimin mbi fitimin" gëzojnë të drejtën e këtyre lehtësive deri në fund të vitit 1995.

Neni 17

Ligji nr.7544, datë 6.1.1992, ndryshuar me ligjin nr.7587, datë 14.7.1992 "Për tatimin mbi fitimin" si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.482, datë 9.3.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.